



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

Numri i lëndës: 2023:024625

Datë: 14.10.2024

Numri i dokumentit: 06293027

**Ac.nr.6255/2023**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Enes Mehmeti dhe Faton Ademi - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M. L. nga P., mësimdhënëse pranë SH.M.M “Luciano Motroni” në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson av. B.K. nga P., kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i shujtave ditore, vlera e kontestit 354.00 euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.218/2023, të datës 25.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.10.2024 nxjerr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET si e pathemeltë** ankesa e të paditurës, Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.218/2023, i datës 25.07.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m i**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.218/2023, të datës 25.07.2023, në pikën e parë të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses M. L. nga P.. Në pikën e dytë të dispozitivit e ka detyruar të paditurës, Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, që paditëses M.L., t’ia paguajë kompensimin e ushqimit gjatë ditëve të pranisë në punë për vitin 2021 dhe atë për 177 ditë të pranisë në punë nga 2 (dy) euro për një ditë pune, gjithsej vlerën e përgjithshme prej 354.00 € (treqind e pesëdhjetë e katër euro) dhe atë me kamatë ligjore prej 8 % në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga dita e paraqitjes së padisë (26.01.2023) deri në pagesën definitive, në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm. Në pikën e tretë të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që paditëses t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore shumë prej 125 € (njëqind e njëzet e pesë) euro në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur e paditura, për shkak të shkëljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar duke e refuzuar në tërësi si të pa themeltë kërkesëpadinë e paditëses.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të të njëjtave, e në kuptim të nenit 194, 195 dhe 200 të LPK-së, gjeti se:

### **Ankesa e paditurës është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja M. L., përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar Betim Kadolli, avokate nga Prishtina, me datë 26.01.2023, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit me kërkesë për kompensimin e shujtave ditore për ushqim në punë gjatë vitit 2021.

E paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale për Arsim, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar, duke kërkuar që Gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditëses se i takon kompensimi i shujtave është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 i Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësja nuk ka paraqitur fakte se është anëtare e kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësja ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësja nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, ashtu që i janë drejtuar Gjykatës në kundërshtim me nenin 124 paragrafin 6.1 të Ligjit për Procedurën Administrative. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura thirret në atë se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAK, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAK. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadija e paditësve të refuzohet në tërësi si e pabazuar si dhe ka kërkuar shpenzimet procedurale.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, pa shqyrtim kryesor të çështjes, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.218/2023, të datës 25.07.2023, me të cilin ka aprovuar si të themeltë kërkesëpadinë e paditëses duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata e shkallës së parë theksoi se në mes të palëve ndërgjyqjësë në mes të palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësja M. L. është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënëse në SH.M.M “Luciano Motroni”, në Prizren. ndërsa përmes vërtetimit me numër 432/60 të datës 22.04.2022 të lëshuar nga e paditura vërtetoi se paditësja, në periudhën e vitit 2021 ka prezantuar në punë gjithsej 177 ditë pune. Në fund, gjykata e aprovoi si të themeltë kërkesëpadinë e paditëses duke e bazuar vendimin e saj në nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës të datës 22.01.2021. Për sa i përket llogaritjes së kamatës ligjore, gjykata vendosi sipas nenit 382 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet procedurale vendimin e mori bazuar në nenin 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Aktgjykimi i atakuar me ankesë është i rregullt në pikëpamje të strukturës dhe përmbajtjes duke përfaqësuar kështu një vendim i cili është koherent në pikëpamje logjike dhe juridike duke eliminuar çfarëdo kontradikte për ta kualifikuar si kundërtëhënës. Mënyra e zhvillimit të procedurës dhe e hartimit të vendimit nga gjykata e shkallës së parë kanë garantuar një proces të drejtë dhe të paanshëm duke u mbështetur për përfundimin e saj në themelin faktik dhe juridik të çështjes.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pa bazuara pretendimet ankimore e të paditurës për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse.

Gjykata e Apelit i refuzon si të pabazuara pretendimet ankimore të palës së paditur e cila në ankesë thekson se sipas dispozitës ligjore të nenit 46 paragrafi 2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë parashihet se nënshkruesit e saj siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave angazhohen bashkërisht për ndarjen e mjeteve financiare për Komunat, ndërsa nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Gjykata e Apelit konsideron se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, obligimi

për përmbushjen e të drejtave të punësuarve të parapara me këtë kontratë, i takojnë pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura dhe në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësen, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Gjykata e Apelit vlerëson se, në rastin konkret është obligim i të gjitha institucionet edukativo arsimore publike dhe private të zbatojnë këtë kontratë, pasi që e njëjta është nënshkruar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK-ut, prej së cilës rrjedhin detyrime të cilat është e obliguar e paditura t'i përmbush, gjegjësisht përgjegjësia për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe të drejtat tjera të cilat u përkasin punonjësve të arsimit ku sipas nenit 2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë është përcaktuar zbatimi i kësaj kontratë " 1. Për të drejtat dhe obligimet që nuk janë përfshirë në këtë Kontratë, zbatohet legjislacioni në fuqi dhe Kontrata kolektive e përgjithshme. 1.1. Dispozitat e kësaj Kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK - ut. 1.2. Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat- DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT - in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo - arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës. Prandaj, thëniet e të paditurës se kërkesëpadia duhet refuzuar, nga shkaku se nënshkruerit e marrëveshjes nuk ia kanë siguruar të paditurit mjetet për buxhet për pagesë nuk janë të bazuara, duke marrë parasysh se ai shkak i cili do ta lironte të paditurën nga përgjegjësia, nuk është paraparë as me dispozitat e ligjit e as të Kontratës kolektive, e as përfaqësuesi i të paditurit nuk ka provuar në ndonjë mënyrë tjetër se thëniet e tij janë të bazuara.

Gjykata e Apelit, po ashtu e ka vlerësuar pretendimin ankimor të palës së paditur e cila në ankesë ka theksuar se paditësja nuk i ka shtjerr mjetet e brendshme për ankesë në kuptim të nenit 78 paragrafi 1 dhe nenit 79 të Ligjit të Punës 03/L-212 dhe gjeti se ky pretendim ankimor nuk është i bazuar për faktin se e drejta e punës është kategori kushtetuese dhe e garantuar me konventa ndërkombëtare dhe me ligj, në rast të paraqitjes së kërkesës së punonjësit për kompensim dëmi apo në kërkesat e tjera në të holla-para nga marrëdhënia e punës (kërkesat materiale) punonjësi nuk ka nevojë që paraprakisht t'i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashtrimin e padisë në gjykatë, e kjo duke u bazuar në nenit 87 të Ligjit të Punës, pasi që me dispozitën e këtij neni është paraparë qartë se: "Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës", andaj nga kjo dispozitë rezulton se paditësja brenda afatit të cekur më lartë mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore për kërkesat të cilat rrjedhin nga marrëdhënia e punës në para, dhe kjo asesi nuk nënkupton se paditësja nuk mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore pa i shtjerr mjetet juridike tek e paditura ashtu siç pretendon e paditura, përkundrazi, e paditura ka pas obligim ligjor që të përmbush detyrimin e saj ndaj paditëses në shumën e kërkuar dhe të aprovuar me kërkesëpadi në bazë të dispozitave të cekura më lartë.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses që në emër të kompensimit të ushqimit për ditët e pranisë në punë t'ia kompensojë shumat e aprovuara si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Gjithashtu edhe për lartësinë e kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe në mënyrë të ligjshme, pasi që në shkresat e lëndës ka pasur prova të mjaftueshme siç është vërtetimi lidhur me ditët e pranisë në punë për paditësen, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjithashtu, edhe vendosja lidhur me kamatëvonesën, është në përputhje të plotë me nenin 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili përcakton detyrimin e debitorit në pagesën e kamatëvonesës si pasojë e vonesës në përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit, e në rastin konkret e paditura meqë, është vonuar dhe nuk ka përmbushë detyrimin e saj ndaj kreditorit në afatin e përcaktuar me kontratë kolektive, atëherë e njëjta i detyrohet në përmbushjen e detyrimit së bashku me kamatëvonesën në shkallë prej 8% vjetore.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitatat nenit e 452 të LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifatat për shpenzime gjyqësore.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të paditurës, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.6255/2023, datë 14.10.2024**

**Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,**  
**Ardian Ajvazi**